



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:117402
Datë: 02.04.2025
Numri i dokumentit: 07073199

C.nr. 537/24

GJYKATA THEMELORE PEJË - Departamenti i përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Vegim Maloku, në çështjen juridiko-kontestimore të paditësit M. A. nga fshati V. të cilën e përfaqëson Shqiponjë Beqiraj avokate në Pejë, kundër të paditurve G. L. dhe A. L. që të dyja nga fshati V., tani me adresë te pa njohur, baza juridike vërtetim pronësie, vlera e kontestit 5,500 euro, jashtë seancë me datën, 02.04.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. HUDHET poshtë padia e paditësit M. A. nga fshati V., kundër të paditurve G. L. dhe A. L. që të dyja nga fshati V., tani me adresë te pa njohur, baza juridike vërtetim pronësie, vlera e kontestit 5,500 euro, si e palejueshme.

Arsyetim

Paditësit, në këtë gjykatë me datë,, kundër ish të paditurit R. L. kanë ushtruar padi, me bazë vërtetim pronësie, vlera e kontestit 2.000 euro.

Me datën 19.09.2023, gjykata ka marrë aktvendimin C.nr.1172/20 për ndërprerje të procedurës, për shkak të vdekjes së të paditurit R..

E autorizuar e palës paditëse, me parashtresën e datës 21.02.2024, ka propozuar që të vazhdohet procedura e ndërprerë tek trashëgimtarët e ish të paditurit R., tani të paditurat G. dhe A..

Gjykata, përkundër faktit që ka tentuar që të bie në kontakt me të paditurat, duke kërkuar informata nga zyra gjendjes civile në Pejë dhe Policia e Kosovës, nuk ka arritur, andaj me qëllim të krijimit të kushteve procedurale, ka vendosë që të paditurave duhet të iu caktohet përfaqësuesi i përkohshëm.

Gjykata me qëllim të krijimit të kushteve procedurale me Aktvendimin C.nr.537/24, të datës 07.03.2025, e ka obliguar paditësin që brenda afatit prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, që në llogarinë bankare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës në Prishtinë, e përmes arkës së kësaj gjykate, në emër të shpenzimeve të cilat do të krijohen rreth caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurat G. dhe A., tani me adresë të panjohur, të deponojë shumën prej 1.200 euro, si dhe gjykatës të ja prezentojë dëshminë për deponimin e bërë, duke e paralajmëruar për pasojat procedurale së nëse pala paditëse brenda afatit prej 7 ditëve nga dita e pranimit të vendimit, nuk e dorëzon dëshminë mbi deponimin e bërë të shumë së cekur gjykata do ta hedhë poshtë padinë.

Nga fletë dërgesa për dorëzim personal gjykata ka konstatuar e autorizuar e paditësit aktvendimin C.nr.537/24, të datës 07.03.2025 për deponimin e shpenzimeve në emër të shpenzimeve për përfaqësuesin e përkohshëm e ka pranuar me datë 14.03.2025, kurse nuk ka bërë deponimin e mjeteve sipas detyrimit të dhënë nga gjykata.

Me dispozitën e nenit 79.3 pika a) të Ligjit të Procedurës Kontestimore shprehimisht thuhet “gjykata do të caktoj palës së paditur përfaqësuesin e përkohshëm, në qoftë se vendqëndrimi i të paditurit është i panjohur, kurse i padituri nuk ka përfaqësues me prokurë, kurse me nenin 81, par. 1 parasheh “ Gjykata e cakton përfaqësuesin e përkohshëm nga radha e avokatëve” si dhe në par. 2 parasheh “Në rastet nga paragrafi 2 i nenit 79 të këtij ligji i padituri ka për detyrë të deponojë shumën e të hollave për pagimin e shpenzimeve të përfaqësuesit të përkohshëm, kurse në rastet nga paragrafi 3 i të njëjtit nen shpenzimet i deponon paditësi.

Tutje gjykata vë në dijeni për palën paditëse, se deri tek deponimi i mjeteve për përfaqësues të përkohshëm, ka ardhur pasi që ka shtjerrë mundësitë ligjore të komunikimit me palën e paditur dhe pasi që ka marrë informatat e nevojshme nga organet shtetërore kompetente.

Sipas dispozitës së nenit 391. 1, pika g) të LPK-së, shprehimisht parashihet se pas shqyrtimit paraprak të padisë, gjykata me aktvendim e hedhë poshtë padinë si të palejueshme po qe se

konstaton se paditësi brenda afatit të caktuar nga gjykata nuk i ka hequr mungesat nga neni 79 dhe 102 të LPK-së. Në këtë kuptim, gjykata pasi që pala paditëse nuk ka bërë deponimin e mjeteve financiare për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm, e ka hedhë poshtë padinë e paditësit si të pa lejuar.

Prandaj gjykata nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të nenit 79, 81, dhe 391. 1 pika g), të LPK-së, gjeti se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia e palës paditëse e ushtruar kundër palëve të paditura duhet të hedhet poshtë si e palejuar, për çka gjykata edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:117402, C.nr.537/24, **02.04.2025**

Gjyqtari
Vegim Maloku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, përmes kësaj gjykatës.